



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2019

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISE SË PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për “**Bajrami N**” sh.p.k me adresë: rruga Xibrakë - Elbasan, km 13, Labinot Fushë, Elbasan.

Procedura e prokurimit: “**Proçedurë e Hapur**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-33265-08-09-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rikonstruksion në objekte arsimore**” me fond limit: **12,274,333** (dymbëdhjetëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e katërmijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkise për vitin 2019, dhe me afat për kryerjen e punimeve **30 ditë nga data e lidhjes së kontratës**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në proçedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Blerimi” sh.p.k me Nipt: J 62903384 G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **12,000,000** (dymbëdhjetëmilion) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **14,400,000** (katërbëdhjetëmilion e katërqindmijë) **lekë** (me tvsh).

2. “Leon Konstruksion” sh.p.k me Nipt: K 71820009 I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10.787.941,37** (dhjetëmilion e shtatëqind e tetëdhjetë shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e një presje tridhjetë e shtatë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **12.945.529,65** (dymbëdhjetëmilion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë presje gjashtëdhjetë e pesë) **lekë** (me tvsh).

3. “Fled” sh.p.k me Nipt: K 17621104 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10,816,708** (dhjetëmilion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e tetë) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **12,980,050** (dymbëdhjetëmilion e nëntëqind e tetëdhjetëmijë e pesëdhjetë) **lekë** (me tvsh).

4. “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10,389,974** (dhjetëmilion e treqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **12.467.968,8** (dymbëdhjetëmilion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje tetë) **lekë** (me tvsh).

5. “Aurora Konstruksion” sh.p.k. me Nipt: K 02017003 I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **12,150,964** (dymbëdhjetëmilion e njëqind e pesëdhjetëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **14,581,157** (katërmëdhjetëmilion e pesëqind e tetëdhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) **lekë** (me tvsh).

6. “Elda - VL” sh.p.k me Nipt: K 67106202 W

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k me Nipt K 71820009 I
- Operatori ekonomik “Fled” sh.p.k me Nipt K 17621104 C
- Operatori ekonomik “Elda - VL” sh.p.k me Nipt K 67106202 W

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” sh.p.k skualifikohet për arsye se : Nga verifikimi rezultoi se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “**Leon Konstruksion” sh.p.k.** të kishte gabim aritmetik prej 18,65 %. Oferta e korigjuar për këtë operator ekonomik është **13,261,944** (trembëdhjetëmilion e dyqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e dyzet e katër) **lekë pa t.v.sh.**

Referuar VKM 914 , neni 66, pika 4 : Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Sa mësipër, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **“Leon Konstruksion” sh.p.k.** refuzohet.

2. Operatori ekonomik “Fled” sh.p.k skualifikohet për arsye se: **nuk përmbush kriterin e përcaktuar në DST pika 2.3.7 të kapacitetit teknik ku thuhet** : Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi e sigurimit teknik (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve , si mëposhte :

2 (dy) punonjës teknik ndertimi

2 (dy) punonjës hidraulik

2 (dy) punonjës elektrikist

2(dy) punonjës murator

2 (dy) punonjës pllakashtrues

2 (dy) punonjës hidroizolues

Per punonjës të mesipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme ; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik (te vlefshme), si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën **Janar 2019 – Qershor 2019**.

- Agron Sula dhe Ardian Brahimaj janë deklaruar nga shoqëria si Hidraulik por bazuar në listepagesat e shoqërisë “Fled” shpk të paraqitura në SPE për periudhën **Janar 2019 – Qershor 2019** si dhe bazuar në VKM nr 514, datë 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Agron Sula dhe Ardian Brahimaj të deklaruar si Hidraulik me kode respektive **8114.08 dhe 9312.02** sipas VKM se sipërcituar, këto kode figurojnë të jenë punëtor i makines së produktve minerale dhe punëtor krahu.
- Andrea Bitri dhe Ermir Marra janë deklaruar nga shoqëria si Elektricitist por bazuar në listepagesat e shoqërisë “Fled” shpk të paraqitura në SPE për periudhën **Janar 2019 – Qershor 2019** si dhe bazuar në VKM nr 514, datë 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Andrea Bitri dhe Ermir Marra të deklaruar si Elektricitist me kode të njëjta **8332.04** sipas VKM se sipërcituar, këto kode figurojnë të jenë drejtues të makinave të betonit.
- Flor Toska dhe Ramis Salaj janë deklaruar nga shoqëria si Murator por bazuar në listepagesat e shoqërisë “Fled” shpk të paraqitura në SPE për periudhën **Janar 2019 – Qershor 2019** si dhe bazuar në VKM nr 514, datë 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN

E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Flor Toska me kodin **8332.14** sipas VKM se sipercituar ky kod figuron te jete shofer kamioni ndersa Ramis Salaj me kod **5414.02** nuk ekziston fare si kod ne listen kombetare te profesioneve.

- Gezim Gjolena dhe Ermal Marra jane deklaruar nga shoqeria si Pllakashtrues por bazuar ne listepagesat e shoqerise "Fled" shpk te paraqitura ne SPE per periudhën **Janar 2019 – Qershor 2019** si dhe bazuar ne VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Gezim Gjolena dhe Ermal Marra te deklaruar si Pllakashtrues me kode respektive **9312.02 dhe 2611.03** sipas VKM se sipercituar, keto kode figurojne te jene punetor krahu dhe jurist .
- Nauren Daka dhe Enrik Demo jane deklaruar nga shoqeria si Hidroizolues por bazuar ne listepagesat e shoqerise "Fled" shpk te paraqitura ne SPE per periudhën **Janar 2019 – Qershor 2019** si dhe bazuar ne VKM nr 514, date 20.09.2017 "PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR": rezulton se Nauren Daka dhe Enrik Demo te deklaruar si Hidroizolues me kode respektive **8322.01 dhe 9312.02** sipas VKM se sipercituar, keto kode figurojne te jene shofer dhe punetor krahu.

b) Operatori ka dorezuar nje preventiv jo te plote , pasi per zerat me nr analize AN "V. pompe + kit (vendosja puntori +sp)", me nr analize 2.a-131 "Tubo fleksibel ø 25 mm2" dhe me nr analize 3. 371/2/an "Xhama te temperuara" nuk ka ofertuar asnje çmim, ndaj dhe oferta e tij bazuar ne kete preventiv, nuk eshte e rregullt.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : "[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]"

"Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji."

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

3. Operatori ekonomik “Elda - VL” sh.p.k skualifikohet për arsye se: nuk ka paraqitur oferte ekonomike si dhe dokumentacionin ligjor, ekonomik-financiar dhe teknik ne permbushje te kriterëve te DST-se.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Bajrami N”** sh.p.k me adresë: rruga Xibrakë - Elbasan, km 13, Labinot Fushë, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **10,389,974** (dhjetëmilion e treqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve Publike)**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5** (pese) **ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktor do të anulojë procedurën, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 03.10.2019

Ankesa nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
Zv.Kryetari
Vesa Liço**